



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3639/7 prot.

Datë 12.01.2026

V E N D I M
Nr. 48/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Deja” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-64014-10-08-2025, me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullosore (Ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë”, me fond limit 12,616,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Deja” SHPK, (BOE “*Lurimi*” SHPK & “*Deja*” SHPK)

Ankimues:

Operatori ekonomik “Deja” SHPK, me NIPT K37509969C dhe adresë: Lagja Nr.1, Rruga Strasburgu Nr 21, Kamëz, Tiranë.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik BOE “Lorenzo & Co” SHPK “Sphaera” SHPK me NIPT J61903071B, J81809003U dhe adresë: Rruga Dritan Hoxha, Pallati i Ri 8 - katesh, perballë Procredit Bank, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Mirditë.

Adresa: Sheshi “Abat Doçi”, Rrëshen.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 09.10.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me REF-64014-10-08-2025, me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullosore (Ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë”, me fond limit 12,616,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

II.2. Më datë 20.11.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 03.11.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Deja	12 591 510	lekë	Skualifikuar
Etta Cons	9 600 045	lekë	Skualifikuar
Joklen & Co	9 588 445	lekë	Skualifikuar
BOE “Lorenzo & Co” & ‘Sphaera’	9 486 400	lekë	Kualifikuar
BOE “Lurimi” &”Deja”	9 462 375	lekë	Skualifikuar
BN Project	pa ofertë ekonomike		Skualifikuar
Diava Consulting	pa ofertë ekonomike		Skualifikuar

II.4. Në datën 06.11.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me A/2025/6185 dhe me nr.3639/2025 prot, datë 19.12.2025 e operatorit ekonomik “Deja” SHPK, (BOE “Lurimi” &”Dea” SHPK), duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Lurimi” &”Dea” SHPK dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Lorenzo & Co” SHPK & “Sphaera” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe u publikua formulari për publikim me nr.3639/1 prot., datë 22.12.2025.

II.6. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me anë të shkresës nr.1409/27, datë 29.12.2025, me objekt “Kthim përgjigje”, protokolluar me tonën me nr.3639/3 prot., datë 30.12.2025, ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimin nr.146, datë 29.12.2025, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimeues ‘Deja’ SHPK.

II.7.Referuar vendimit nr.146, datë 29.12.2025 të KSHA, rezulton se ky i fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes dhe në përfundim ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke argumentuar si më poshtë:

[...]Pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të secilit operator ekonomik të vënë në dispozicion nga Komisioni I Vlerësimit të Ofertave, Komisioni I Shqyrtimit të Ankesës, konkludon:
...

BOE “LORENCO & CO” shpk & “SPHAERA” shpk me vlerë: 9 486 400 (Nëntë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) Lekë pa Tvsh- nuk ka përmbushur pikën 2.3.1 dëshmi për shërbime të ngjashme dhe pikat 2.3.1/a dhe 2.3.1/b sipas përqindjes së pjesëmarrjes së tyre në bashkim; Faturat tatimore të paraqitura nga “SPHAERA” nuk janë sipas objektit të prokurimit; “SPHAERA” shpk nuk disponon licencë nga QKB “Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet/kullotat”,... dhe skualifikohet.

- BOE “LURIMI” shpk & “DEJA” shpk me vlerë: 9 462 375 (Nëntë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) Lekë pa Tvsh - Njëri nga anëtarët e bashkimit të operatorëve OE “DEJA” shpk, ka paraqitur ofertë të pavarur me vlerë: 12 591 510 Lekë pa Tvsh, dhe skualifikohet, referuar nenit 81 të Vkm-së nr.285, dt 19.05.2021 e ndryshuar, ku citohet “Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

Referuar shqyrtimit të mësipërm,

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESËS

VENDOSI

- Pranimin e pjesshëm të ankesës
- Skualifikimin e BOE “LORENCO & CO” shpk & “SPHAERA” shpk;
- Kalimin për rivlerësim nga Komisioni I Vlerësimit të Ofertave të procedurës me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullosore (Ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë” me nr. REF- 64014-10-08-2025.

II.8.Vendimin e KSHA nr.146, datë 29.12.2025, protokolluar me tonën me nr.3639/4 prot., datë 30.12.2025 , lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimes ‘Deja’SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë KPP edhe nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorëve ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Deja” SHPK, (BOE “Lurimi” & “Deja” SHPK) mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik BOE “Lorenzo & Co” SHPK & “Sphaera” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me anë të shkresës nr.1409/27, datë 29.12.2025, me objekt “Kthim përgjigje”, protokolluar me tonën me nr.3639/3 prot., datë 30.12.2025, ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimin nr.146, datë 29.12.2025, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Deja” SHPK.

II.7. Referuar vendimit nr.146, datë 29.12.2025 të KSHA, rezulton se ky i fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke argumentuar si më poshtë:

[...] Pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të secilit operator ekonomik të vënë në dispozicion nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, konkludon:
...

BOE “LORENCO & CO” shpk & “SPHAERA” shpk me vlerë: 9 486 400 (Nëntë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) Lekë pa Tvsh- nuk ka përmbushur pikën 2.3.1 dëshmi për shërbime të ngjashme dhe pikat 2.3.1/a dhe 2.3.1/b sipas përqindjes së pjesëmarrjes së tyre në bashkim; Faturat tatimore të paraqitura nga “SPHAERA” nuk janë sipas objektit të prokurimit; “SPHAERA” shpk nuk disponon licencë nga QKB “Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet/kullotat”,... dhe skualifikohet.

- BOE “LURIMI” shpk & “DEJA” shpk me vlerë: 9 462 375 (Nëntë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) Lekë pa Tvsh - Njëri nga anëtarët e bashkimit të operatorëve OE “DEJA” shpk, ka paraqitur ofertë të pavarur me vlerë: 12 591 510 Lekë pa Tvsh, dhe skualifikohet, referuar nenit 81 të Vkm-së nr.285, dt 19.05.2021 e ndryshuar, ku citohet “Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

Referuar shqyrtimit të mësipërm,

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESËS

VENDOSI

- Pranimin e pjesshëm të ankesës
- Skualifikimin e BOE “LORENCO & CO” shpk & “SPHAERA” shpk;
- Kalimin për rivlerësim nga Komisioni I Vlerësimit të Ofertave të procedurës me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullosore (Ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë” me nr. REF- 64014-10-08-2025.

III.1.3. Neni 30 i LPP-së i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ të pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

Në kushtet kur nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 3639/2025 prot., datë 19.12.2025, të operatorit ekonomik “Deja” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Deja” SHPK (BOE “Lurimi” & “Deja” SHPK) për skualifikimin e operatorit ekonomik “BOE “Lorenzo & Co” SHPK & “Sphaera” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mos i marrë në shqyrtim, përse kohë gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik BOE “Lorenzo & Co” SHPK & “Sphaera” SHPK, referuar arsyetimit të bërë në këtë vendim (sipas vendimit të KSHA) do të ndryshojë nga “e kualifikuar” në “e skualifikuar”, duke përmbushur kështu interesin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik BOE “Lorenzo & Co” SHPK & “Sphaera” SHPK.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Deja” SHPK, (BOE “Lurimi” & “Deja” SHPK) për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyet: *Njëri nga anetarët e BOE (DEJA SHPK), ka paraqitur edhe oferte të pavarur, dhe referuar nenit 81, pika 1 të vkm nr.285, dt 19.05.2021 skualifikohet* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në datën 09.10.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me REF-64014-10-08-2025, me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullosore (Ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë”, me fond limit 12,616,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

III.3.2. Më datë 20.11.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.3.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 03.11.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Deja	12 591 510	lekë	Skualifikuar
Etta Cons	9 600 045	lekë	Skualifikuar
Joklen & Co	9 588 445	lekë	Skualifikuar
BOE “Lorenzo & Co” & ‘Sphaera’	9 486 400	lekë	Kualifikuar
BOE “Lurimi” & “Deja”	9 462 375	lekë	Skualifikuar
Bn Project	pa ofertë ekonomike		Skualifikuar
Diava Consulting	pa ofertë ekonomike		Skualifikuar

III.3.4. Operatori ekonomik ankimues “Deja” SHPK (BOE “Lurimi” & “Deja” SHPK) rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi me arsyen “*Njëri nga anetarët e BOE (DEJA SHPK), ka paraqitur edhe oferte të pavarur, dhe referuar nenit 81, pika 1 të vkm nr.285, dt 19.05.2021 skualifikohet*”.

III.3.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Deja” SHPK, (BOE “Lurimi” & “Deja” SHPK) për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyet: *Njëri nga anetarët e BOE (DEJA SHPK), ka paraqitur edhe oferte të pavarur, dhe referuar nenit 81, pika 1 të vkm nr.285, dt 19.05.2021 skualifikohet, nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit*

objekt ankimi dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, ankimuesi ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit duke paraqitur dy oferta të veçanta, konkretisht një ofertë si operator ekonomik i vetëm “Deja” SHPK me vlerë 12 591 510 lekë pa tvsh dhe një ofertë tjetër si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE) “Lurimi” & “Deja” SHPK me vlerë 9 462 375 lekë pa tvsh. Kjo mënyrë e të ofertuarit, ky veprim i ofertuesit bie në kundërshtim me nenin 81 “Ndërhyrja në ofertë” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: “Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.” Qëllimi i këtij dispozite është garantimi i konkurrencës së ndershme, transparencës dhe barazisë së trajtimit të operatorëve ekonomikë, duke shmangur çdo formë ndikimi, koordinimi ose manipulimi të procesit konkurrues përmes paraqitjes së më shumë se një oferte nga i njëjti subjekt. Në këtë kuptim, pjesëmarrja e operatorit ekonomik ankimues në dy oferta të ndryshme, pavarësisht formës juridike të paraqitjes (individualisht ose si pjesë e BOE-së), përbën ndërhyrje në ofertë, e cila sanksionohet nga legjislacioni në fuqi me përjashtim të të gjitha ofertave ku operatori është i përfshirë. Në rastin konkret, Komisioni vlerëson se oferta e operatorit ekonomik ankimues “Deja” SHPK si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik BOE “Lurimi” & “Deja” SHPK refuzohet në zbatim të nenit 81 të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron,

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik” Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Deja” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-64014-10-08-2025, me objekt: “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe kullimore (Ekonomia pyjore Kaçinar), Bashkia Mirditë”, me fond limit 12,616,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Lorenzo & Co” & ‘Sphaera’ SHPK, duke e skualifikuar atë, në zbatim të vendimit të KSHA nr.146, datë 29.12.2025.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Deja” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik, “Deja” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiovent Zguro

